



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA –SUHAREKË
OPSTINE SUVA REKA
THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA



ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS
KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

Nr.Prot.	01/2026
Për:	Kryesuesin e Kuvendit të Komunës së Suharekës- z. Bexhet KUÇI
Nga:	Kryetari i Komunës në Suharekë njëherit Kryesues i KKSB-së
Lënda:	Informatë për aktivitet e KKSB-së për periudhën Janar-Qershor 2026
Datë:	03.07.2026

Nga takimet e Këshillit Komunal për Sigurinë e Bashkësive “KKSB” në Komunën e Suharekës, të paraparë sipas Udhëzimit Administrativ të nënshkruar nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal 27/2012, MPB dhe 03/2012, MAPL për themelimin e Këshillave Komunale për Siguri në Bashkësi KKSB dhe në mbështetje të Planit vjetor të punës për këshillin komunal për siguri në bashkësi për periudhën prill-dhjetor 2026 ju dërgojmë këtë:

I N F O R M A T Ë

Pas konstituimit të organeve të Komunës në Suharekë, të daluar nga zgjedhjet lokale të vitit 2025, Kuvendi i Komunës në muajin shkurt të vitit 2026, ka themeluar Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB-në), konform Ligjeve dhe akteve tjera nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës, si organ këshillues për çështjet e sigurisë në bashkësi me përfaqësim të gjerë të të gjitha komuniteteve dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, në tekstin e metejm (KKSB-ja) për periudhën Janar-Qershor të vitit 2026, ka mbajtur dy (2) takime të rregullta dhe ato konform planit të veprimit të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Suharekës.

Në këto takime kanë marrë pjesë kryesisht shumica e anëtarëve të KKSB-së.

Në takimin e parë (1) të rregullt, të mbajtur me datën 08.04.2026, tema diskutimi kanë qenë:

- **Vlerësimi i përgjithshëm i sigurisë në territorin e Komunës së Suharekës;**
- **Vetëdijesimi i nxënëseve për rrezikun nga minat dhe mjeteve të tjera të pa shpërthyer nga lufta;**
- **Identifikimi i hapësirave publike ku cenohet lëvizja e lire e qytetarëve;**
- **Trajtimi i qenve endacak;**

Sa i përket sigurisë në territorine Komunës së Suharekës është e qetë në këtë 3 muor tek vjedhjet kemi rënje -11% krahasuar me vitin e kalum, aksidente në këtë 3 muor kemi pas rënje, në përgjithësi dëshmin e veprave penale si stacion e kemi

shumë mire dikun 77.2%, vrasje grabitje nuk ka, në përgjithësi e kemi një bashkëpunim të mire në Komunen dhe Shkollat jemi shumë të angazhum në ligjerata me nxënës për çështjen e sigurisë.

Kjo pikë është një ndër pikat që është diskutu në vazhdimësi për qdo periudhë të pranverës me qëllim që të bëhet vetëdijësimi i nxënësve veqanarisht në 3 Shkollat e mesme ku ata janë me të vetdijëshem dhe frekuentojnë ambiente të ndryshme për këtë kemi pas bashkëpunim të vazhdueshëm me FSK-ën dhe me Policin e Kosovës të cilët kanë mbajtur ligjerata informuese dhe sensibilizuese.

Problemi i qenve endacak është problem madhor në gjithë Kosovën. Ne si komunë vazhdimisht kemi bërë përpjekje për të bërë zgjidhje optimale apo të qëndrueshme por është një problem i cili është vështirë për tu zgjidhur.

Konkluzion apo rekomandim nga ky takim ka dalë:

- *Si çdo herë të vazhdojë bashkëpunimi mes policisë dhe komunitetit dhe institucioneve tjera përgjegjëse.*
- *DKA të përgadit orarin dhe të bën kërkesë në FSK, ekipa e specializuar që është për çështjen e trajnimeve mbajtjen e ligjeratave për nxënësit e Shkollave të Mesme aty ku e vlerëson dhe e konsideron DKA-ja që është e nevojshme të mbahen këto ligjerata dhe ta adreson kërkesën tek organi kompetent që të fillon procedurat para se me përfundim viti shkollor.*
- *Drejtoria e Inspeksionit në bashkëpunim me policinë ti lirojnë hapësirat publike për lëvizjen e lirë të qytetarëve për shkak të investimeve që po bëhen në qytet.*

Në takimin e dytë (2) të rregullt të mbajtur me datën 16.06.2026, tema diskutimi kanë qenë:

- **Diskutim për aktivitetet e organizuara nga Drejtoria e Arsimit për maturantët;**
- **Prishja e rendit dhe qetësisë publike nga lokalet e natës dhe personat e papërgjegjshëm;**
- **Përgaditja dhe vetëdijësimi i qytetarëve për mbrojtje nga zjarri gjatë sezonit veror;**
- **Mungesa e trotuareve dhe shenjave sinjalizuese në territorin e komunës;**

Sipas statistikave që ka DKA-ja këtë vit janë regjistruara 571 maturantë mirëpo ka pas lëvizje gjatë vitit dhe tani është numri më i vogël për 11 maturantë. Procesi mësimor për maturantët ka përfunduar me 14.05.2026 dhe sipas planit të punës është organizuar edhe testi i brendshëm në dy shkollat profesionale. Në bazë të planifikimit shkollat këtë vit kanë organizuar ekskurzionin e maturantëve në shtetin e Shqipërisë dhe të tri shkollat i kanë realizuar pa asnjë incident dhe procesi ka rrjedh sipas planifikimit. Gjithëashtu janë organizuar edhe mbrëmjet e maturës për tri shkollat dhe raportet tregojnë se ka rrjedh pa ndonjë pengesë apo problem. Me 20 qershor bëhet organizimi i testit të maturës ku do të nënshtrohen 560 maturantë dhe të gjithë kanë aplikuar në sistemin eksova. Jemi në përgaditjet e fundit të organizimit të qendrave të testimit dhe planifikojmë që këtë vit ti organizojmë në tri shkollat e mesme katër qendra testimi.

Sa i përket prishjes së rendit dhe qetësisë publike nga lokalet e natës dhe personat e pa përgjegjshëm situatën në përgjithësi e kemi të qetë me prijashtim të

ndonjë rasti i cili pas njoftimit që bëhet nga qytetarët policia e Kosovës menjher këto raste i ndalon me qellim që të ju krijohet kushte për jetës dhe siguri qytetareve.

Komuna jonë në vazhdimësi për çdo vit bën parapërgaditjen për çështjen e vetëdijësimit të qytetarëve dhe për mbrojtjen nga zjarri gjatë sezonit të verës. Ne çdo herë e bëjmë një apel përmes faqes së komunës që mundësisht gjatë verës dhe temperaturave të larta, qytetarët mos të ndezin zjarre sepse shkaktohen zjarre të mëdhaja dhe është problem. Ne gjithëashtu çdo herë i njoftojmë edhe pishinat që nëse ka nevojë, zjarrfikësat me u furnizim me ujë nëse ndodh një fatkeqësi e zjarrit.

Sa i përket mungesës së trotuareve ne veq e kemi diskutu paraprakisht dhe i kemi lëshu një rekomandim inspektoriatit dhe policisë që të bëj lirim të hapësirave publike, lëvizjen e lire të qytetarëve sidomos nëpër qytet dhe rrugëve nëpër periferi.

Konkluzion apo rekomandim nga ky takim ka dalë:

- *Të ngritët vigilenca nga ana e policisë për ruajtjen e sigurisë dhe qetësisë për sezonin veror; Motoja të jetë publike “Festo me zemër dhe jo me armë” gjatë abengjeve familjare;*
- *Konkluzion tjetër apo rekomandim nga ky takim ka qenë që të shtohet numri i zjarrfikësve gjatë sezonit të verës, të merren masa preventive për mos djegien e fushave, të njoftohen me shkrim pishinat për raste emergjente për furnizim me ujë nga pishinat dhe në raste emergjente të bashkëpunohet me FSK;*
- *Policia së bashku me inspektoratin ta ngrisin vigjilencën gjatë periudhës sa janë mërgimtarët por jo duke përjashtuar vazhdimin e ngritjes së vigjilencës së kontrollimit dhe mbajtjes nën kontroll të të gjitha lokaleve të cilët punojnë më tepër se sa është e përcaktuar me fillimin dhe mbarimin e orarit të punës.*
- *Komuna ta ketë parasysh që të gjitha rrugët që nuk kanë trotuar, të rregullon trotuaret dhe të bëj sinjalizimin e rrugëve aty ku ka nevojë, edhe sipas kërkesës së policisë. Policia në bashkëpunim me Inspeksionin të lirojnë trotuarët me qëllim të lëvizjes së lire të qytetarëve.*

Me respekt!

Kryetari i Komunës

Bali MUHARREMAJ